

Nr. 830/1 Prot.  
Dt. 28.02.2019



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
PREFEKTI QARKU FIER

Nr. 378/1 Prot.

Fier, më 27.02.2019

**Lënda:** Kthim përgjigje për ligjshmërinë e vendimeve të Këshillit Bashkiak Roskovec.

**Drejtuar:** Znj. Majlinda **BUFI**  
Kryetare e Bashkisë Roskovec. ✓

**ROSKOVEC**

**Për dijeni:** Znj. Eleni **GOGA**  
Kryetare e Këshillit Bashkiak Roskovec.

**ROSKOVEC**

Në përgjigje të shkresës tuaj me Nr.830 prot. datë 21.02.2019, bazuar në Ligjin Nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" neni 16, shqyrtuam vendimet e Këshillit të Bashkisë Roskovec të datës 19.02.2019 si më poshtë vijon:

**Vendimi Nr. 08 datë 19.02.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec "Mbi miratimin e fondit për pagesën e personave me aftësi të kufizuar dhe invalidëve të punës për periudhën 1-28 shkurt 2019"** Eshtë në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore"; Ligjin Nr.9355 Datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" (i ndryshuar) si dhe në zbatim të VKM Nr. 955, datë 7.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike."

**Vendimi Nr. 09 datë 19.02.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec "Për propozim për dhënie e ndihmës ekonomike për periudhën 1-28 2019"** Eshtë në përputhje me Ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" nenet 9 dhe 54; Ligjin Nr.9355 Datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" (i ndryshuar) dhe në zbatim të VKM Nr. 955 Datë

07.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” (i ndryshuar) kreu II pika 6.

**Vendimi Nr. 10 datë 19.02.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për periudhën 1-31 janar 2019”** Është në përputhje me Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 9, 24, 54; Ligjin Nr.9355 Datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”(i ndryshuar);VKM Nr. 955 datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve proceduriale si dhe dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.5 datë 17.2.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6% (i ndryshuar).

**Vendimi Nr. 11 datë 19.02.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për anulimin pjesërisht të vendimit Nr.06 datë 19.01.2019 të KB Roskovec “Për miratim fondesh” pika 2** Është në përputhje me Ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” neni 113.

**Vendimi Nr. 12 datë 19.02.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për një ndryshim në vendimin nr.93 datë 19.11.2018 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2019”** Është në përputhje me Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 54 shkronja “f” si dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2018 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar).

**Vendimi Nr. 13 datë 19.02.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Miratimin e raportit për vlerësimin dhe parashikimin afatmesëm të të ardhurave 2020-2022”** Është në përputhje me ligjin Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 34 si dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.03 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njërive të vetëqeverisjes vendore”.

**Vendimi Nr. 14 datë 19.02.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Miratimin e raportit të monitorimit për 4 mujorin e III/vjetor të vitit 2018.** Është në përputhje me ligjin Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” si dhe Udhëzimin e Nr.22 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njërive të qeverisjes vendore”

**Vendimi Nr. 15 datë 19.02.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për një ndryshim të listës së inventarit, miratuar me VKM Nr.241 datë 25.04.2007 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në Komunën Strum, të Qarkut**

**Fierit**". Është në përputhje me Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 9 pika 1.2 shkronjat "a" dhe "c"; neni 54; si dhe në zbatim të Ligjit Nr.8744 datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" (i ndryshuar) dhe VKM nr.241 datë 25.04.2007 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shetërore në Komunën Strum të Qarkut Fier"

**Vendimi Nr. 16 datë 19.02.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec** "Për marrjen me qira të ambientit për tu përdorur për nevojat e ndërmarrjes së shërbimeve të mirëmbajtjes" Është në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 9 pika 1.6 "a" dhe neni 23.

**Vendimi Nr. 17 datë 19.02.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec** "Për autorizimin e kryetarit të Bashkisë Roskovec për kryerjen e procedurave të lidhjes së kontratës së shitblerjes" Është në përputhje me Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 8 pika 2; neni 9 pika 1.6 shkronja "a", neni 23, si dhe neni 64 shkronja "b"

**Vendimi Nr. 18 datë 19.02.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec** "Për autorizimin e kryetarit të Bashkisë Roskovec për firmosjen e marrëveshjes së taksave vendore midis bashkisë dhe kompanisë Bankers Petroleum Albania LTD" Është në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 8 pika 2; neni 9 pika 1.6 si dhe neni 64 shkronja "b".

**PREFEKTI**

**Baki BALA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 831 Prot.

Roskovec, më 21.02 2019

VENDIM

Nr. 8 datë 19.02.2019

**MBI MIRATIMIN E FONDIT PËR PAGESËN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR DHE INVALIDËVE TË PUNËS PËR PERIUDHËN 1-28 SHKURT 2019**

Në mbështetje të nenit 29 pika 2, 30/1, pika 3, 31 të Ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005, "Për Ndhimën dhe Shërbimet Shoqërore" i ndryshuar me Ligjin nr. 44/2016, datë 21.04.2016, të VKM-së nr. 618, datë 07.09.2006 "Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar", i ndryshuar dhe udhëzimeve në zbatim të tyre, Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI :**

**PËR BANORËT E QENDRËS SË BASHKISË ROSKOVEC**

Të përfitojnë pagesë paaftësie për muajin Shkurt 2019 në total **236 (dyqind e tridhjetë e gjashtë)** persona me fond **1754712 (një milion e shtatëqind e pesëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e dymbëdhjetë)** lekë, të ndarë: **110 (njëqind e dhjetë)** persona të paaftë, të verbër, para-tetraplegjik me një fond **1359312 (një milion e treqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e treqind e dymbëdhjetë)** lekë dhe invalid pune **126 (njëqind e njëzetë e gjashtë)** persona, me fond **395400 (treqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e katërqind)** lekë.

Konkretisht:

- |                             |                                      |
|-----------------------------|--------------------------------------|
| 1. Persona të paaftë        | 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) persona |
| 2. Kujdestar paaftësie      | 7 (shtatë) persona                   |
| 3. Persona të verbër        | 12 (dymbëdhjetë) persona             |
| 4. Kujdestar verbërie       | 3 (tre) persona                      |
| 5. Paraplegjik-tetraplegjik | 11 (njëmbëdhjetë) persona            |



- 6.Kujdestar para- tetraplegjik 11 (njëmbëdhjetë) persona  
 7.Invalid pune 126 (njëqind e njëzetë e gjashtë) persona

### PËR BANORËT E NJËSISË ADMINISTRATIVE STRUM

Të përfitojnë pagesë paaftësie për muajin Shkurt 2019 në total **312 (treqind e dymbëdhjetë)** persona me fond **3740440 (tre milion e shtatëqind e dyzetë mijë e katërqind e dyzetë)** lekë të ndarë: **249 (dyqind e dyzetë e nëntë)** persona të paaftë, të verbër, para-tetraplegjik me fond **3530940 (tre milion e pesëqind e tridhjetë mijë e nëntëqind e dyzetë)** lekë dhe invalid pune **63 (gjashtëdhjetë e tre)** persona, me fond **209500 (dyqind e nëntë mijë e pesëqind)** lekë.

Konkretisht:

- 1.Persona të paaftë 128 (njëqind e njëzetë e tetë) persona  
 2.Kujdestar paaftësie 25 (njëzetë e pesë) persona  
 3.Persona të verbër 28 (njëzetë e tetë) persona  
 4.Kujdestar verbërie 11 (njëmbëdhjetë) persona  
 5.Paraplegjik-tetraplegjik 28 (njëzetë e tetë) persona  
 6.Kujdestar para-tetraplegjik 29 (njëzetë e nëntë) persona  
 7.Invalid pune 63 (gjashtëdhjetë e tre) persona

### PËR BANORËT E NJËSISË ADMINISTRATIVE KUMAN

Të përfitojnë pagesë paaftësie për muajin Shkurt 2019 në total **306 (treqind e gjashtë)** persona me fond **3214131 (tre milion e dyqind e katërbëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e një)** lekë të ndarë : **205 (dyqind e pesë)** persona të paaftë, të verbër, para-tetraplegjikë me fond **2888631 (dy milion e tetëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e një)** lekë dhe invalidë pune **101 (njëqind e një)** persona me fond **325500 (treqind e njëzetë e pesë mijë e pesëqind)** lekë.

Konkretisht:

- 1.Persona të paaftë 102 (njëqind e dy) persona  
 2.Kujdestar paaftësie 15 (pesëmbëdhjetë) persona  
 3.Persona të verbër 46 (dyzetë e gjashtë) persona  
 4.Kujdestar verbërie 8 ( tetë ) persona



5.Paraplegjikë-tetraplegjikë	17 (shtatëmbëdhjetë) persona
6.Kujdestar para-tetraplegjik	17 (shtatëmbëdhjetë) persona
7.Invalidë pune	101 (njëqind e një) persona

### PËR BANORËT E NJËSISË ADMINISTRATIVE KURJAN

Të përfitojnë pagësë paaftësie për muajin Shkurt 2019 në total **214 (dyqind e katërbëdhjetë)** persona me fond **2355706 (dy milion e treqind e pesëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e gjashtë)** lekë të ndarë **165 (njëqind gjashtëdhjetë e pesë)** persona të paaftë, të verbër, para-tetraplegjike me fond **2194006 (dy milion e njëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e gjashtë)** lekë dhe invalid pune **49 (dyzetë e nëntë)** persona me fond **161700 (njëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e shtatëqind)** lekë.

Konkretisht:

1.Persona te paaftë	89 (tetëdhjetë e nëntë) persona
2.Kujdestar paaftësie	18 (tetëmbëdhjetë ) persona
3.Persona të verbër	20 (njëzet) persona
4.Kujdestar verbërie	8 ( tetë ) persona
5.Paraplegjik-tetraplegjik	15 (pesëmbëdhjetë) persona
6.Kujdestar para-tetraplegjik	15 (pesëmbëdhjetë) persona
7.Invalid pune	49 (dyzetë e nëntë) persona

**KRYETAR**

**Eleni Goga**

